



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:029515

Datë: 27.06.2024

Numri i dokumentit: 05870449

P.nr.348/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Penal, me gjyqtarin Sabit Sadikaj, me Bashkëpunëtorin profesional Asdren Selmani, në çështjen penale kundër të akuzuarit Irfan Ibrahimimi për shkak të veprës penale “Sulmi” nga neni 184, par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.365/22 te datës: 11.02.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë: 27.06.2024, ku në prezencë të Prokurorit të Shtetit Besart Mustafa, si dhe të pandehurit Irfan Ibrahimimi, me datë: 27.06.2024mori dhe publikisht shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

IRFAN IBRAHIMI, i biri i A dhe M, e vajzërisë B, i lindur më “Data e Lindjes...” në Prishtinë, me vendbanim në rrugën fshatin “vendbanimi”, Komuna e Podujevës, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal “letërnjoftim”, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Më datën 14.01.2022, rreth orës 14:00 në rrugën “emri i rrugës”, në Prishtinë, përkatësisht në Auto servis “F...” në Prishtinë, i pandehuri Irfan Ibrahimimi me dashje e ka përdorur forcën ndaj të dëmtuarit E.H, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje e ka sulmuar fizikisht të dëmtuarin duke e shtyrë me duar.

- Me këtë e ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184, par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 69, 70, 81, 82, të KPRK, si dhe neneve 498, 499, të KPPRK-së, të akuzuarin e gjykon me:

VËREJTJE GJYQËSORE

- I. Me të cilën të pandehurit Irfan Ibrahim, i bëhet me dije se ka kryer veprë penale të dënueshme dhe nëse sërish kryen veprë të tillë gjykata do t'i shqiptojë sanksion më të rreptë, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.
- II. Pala e dëmtuar E.H, në adresë banimi në: Rr. "Emri i Rrugës" Pejë, me nr. kontaktues "Telefon", për të e realizuar kërkesën pasurore-juridike, udhëzohen në kontest civil.
- III. Obligohet i akuzuari që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, ashtu që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20.00 (njëzet) Euro, për programin e kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 20.00 (njëzet) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.365/22 te datës: 11.02.2022, ndaj të akuzuarit Irfan Ibrahim për shkak të veprës penale "Sulmi" nga neni 184, par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me shqyrtimin e kësaj lënde, Gjykata me datë: 27.06.2024, mbajti seancën e shqyrtimit fillestar ku morën pjesë Prokurori i Shtetit Besat Mustafa si dhe i pandehuri Irfan Ibrahim ndërsa i dëmtuari E.M, u ftua përmes telefonit ndërsa pohoj se nuk mund të vije..

Në seancën, e shqyrtimit fillestar i pandehuri Irfan Ibrahim, ka deklaruar, e pranon se është fajtor, nuk e përsërit më dhe është hera e parë.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar, ka deklaruar se: pajtohem me pajtimin e fajësisë i njëjti te merret si rrethane lehtësuese dhe sjellje e te pandehurit pas kryerjes së veprës penale ndërsa si rrethane renduese dashja

Andaj pas pranimit te fajësisë nga të pandehurit dhe deklarimit të Prokurorit të Shtetit, gjykata me aktvendim pranoi, pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pasi që është bindur plotësisht se i pandehuri ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë. Pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se i pandehurit nuk kanë qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe ka mbështetje në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 paragrafi 1 të KPPRK-së. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në dispozitën e nenit 322 par., lidhur me nenin 242 .par.2 të KPPRK-së, lidhur me pranimin e fajësisë.

Nga deklarimet i të pandehurit në shqyrtimi gjyqësor, si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e tij, si dhe nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, u vërtetua se i njëjtit me datë, kohë dhe vendi si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij për shkak se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Duke u bazuar në këto që u cekën me lartë, gjykata konstaton se i akuzuari, është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale "Sulmi" nga neni 184, par. 1 të KPRK-së, nga neni 314 par.6 të KPRK-së ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj veprë penale.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjeti se i njëjti e ka pranuar fajësinë që në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin lidhur me veprën e kryer, se nuk do të kryej vepër tjetër penale, po ashtu i pandehuri është hera par që bije në ndesh me ligjin, ndërsa rrethana renduese gjykata nuk gjeti, andaj të pandehurit i shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se sanksioni i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprës penale si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.1, 452 par.4 të KPPRK-së.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil është marrë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 462 par.2 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 364, 365, 449, 450, 498, 499, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2022:029515, 27.06.2024**

Bashkëpunëtori Profesional:  
Asdren Selmani

Gjyqtari:  
Sabit Sadikaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.